



SQ

Shenjat e gishtave dhe Eurodac

Informacion për shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të gjetur që rrinë në mënyrë të paligjshme në një shtet anëtar, sipas nenit 29(3) të rregullores së (BE) nr. 603/2013

Nëse ju gjendeni që rrini në mënyrë të paligjshme në një vend të 'Dublinit'¹⁾, autoritetet mund t'ju marrin shenjat tuaja të gishtave dhe t'i transmetojnë ato në një bazë të dhënash për shenjat e gishtave të quajtur "Eurodac". Kjo është vetëm me qëllim për të parë nëse ju keni aplikuar më parë për azil. Të dhënat tuaja të shenjave të gishtave nuk do të ruhen në bazën e të dhënave të Eurodac, por nëse ju keni aplikuar më parë për azil në një vend tjetër, ju mund të dërgoheni mbrapsht në atë vend.

Nëse shenjat tuaja të gishtave nuk janë të një cilësie të qartë, përfshirë nëse ju me dashje i keni dëmtuar gishtat, shenjat e gishtave mund t'ju merren përsëri në të ardhmen.

Eurodac operohet nga një Agjensi e Bashkimit Europian e quajtur eu-LISA. Të dhënat tuaja mund të përdoren vetëm për qëllime të identifikuar nga ligji. Vetëm Sistemi Qendror i Eurodac do të marrë të dhënat tuaja. Nëse ju kërkon azil në të ardhmen në një vend tjetër të Dublinit, shenjat tuaja të gishtave gjithashtu do të merren për t'u transmetuar në Eurodac. Të dhënat e ruajtura në Eurodac nuk do të ndahen me asnjë vend ose organizatë tjetër jashtë BE dhe vendeve të asociuara.

-
- 1) Shtrihet në të gjithë Bashkimin Europian (Austrië, Belgjikë, Bullgarië, Kroacië, Qipron, Republikën Çeke, Danimarkë, Estoninë, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Irlandën, Italinë, Letoninë, Lituanië, Luksemburgun, Maltën, Hollandën, Poloninë, Portugalinë, Rumannë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjë, Sëedinë, Mbretërinë e Bashkuar) si dhe 4 vendet "e asociuara" me Rregullin e Dublinit (Norvegjinë, Islandën, Zvicrën dhe Litenshteinin).

©Bashkimi Europian 2014

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose ri-prodhim të fotove individuale leja duhet kërkuar direkt nga mbajtësit e të drejtës së autorit.

Informacion Kontakti

Identiteti dhe detajet e kontaktit të kontrollorit të Eurodac

Departamenti i Migracionit nën Ministrinë e Punëve të Brendshme

L. Sapiegos str. 1, 10312 Vilnius

Tel: +370 5 271 7112

Email: md.rastine@vrm.lt

<http://www.migracija.lt>

Detajet e Autoritetit Kombëtar Mbikqyrës (për mbrojtjen e të dhënave)

Inspektorati Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave

A. Juozapavičiaus str. 6, 09310 Vilnius

Tel: +370 5 271 2804, +370 5 279 1445

Email: ada@ada.lt

<https://www.ada.lt>

Nëse autoritetet tona konsiderojnë se ju mund të keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në një vend i cili mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e atij aplikimi, ju do të merrni informacion më të detajuar rreth procedurës që do të ndiqet dhe sesi ajo ju ndikon ju dhe të drejtat tuaja.



SQ

“Unë jam në procedurën e Dublinit – çfarë do të thotë kjo”

B

Procedura e Dublinit – informacion për aplikantët për mbrojtje ndërkombëtare që gjendet në procedurën e Dublinit, bazuar në nenin 4 të rregullores (BE) Nr. 604/2013

doi:10.2847/21138

ISBN 978-92-9243-167-9

